



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS VITI

Numri i lëndës: 2023:169210

Datë: 26.01.2024

Numri i dokumentit: 05244801

P.nr.335/2023

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA V., Departamenti i Përgjithshëm, përmes gjyqtares Blerina Jakupi Ramadani, me bashkëpunëtorin profesional Fitim Limani, duke vendosur në çështjen penale kundër të pandehurit S.E. nga fshati G., Komuna e V. për shkak të veprës penale vjedhje pylli nga neni 349 paragrafi 1 të KPRK-së, me rastin e vendosjes lidhur me kërkesën e Prokurorisë Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, për dhënien e urdhërit ndëshkimor me numër PP.II.nr.1100/2023, të datës 19.07.2023, pas konstatimit të dhënave në aktakuzë, të cilat ofrojnë bazë të mjaftueshme për dhënien e urdhërit ndëshkimor, me datë 26.01.2024, mori këtë:

AKTGJYKIM

PRANOHET kërkesa e Prokurorisë Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, me numër PP.II.nr.1100/2023, e datës 19.07.2023 dhe gjykata jep këtë:

URDHËR NDËSHKIMOR

I pandehuri S.E. nga fshati G., Komuna e V., nga babai Sami, i lindur me datë 06.05.1982, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal 2002797227.

ËSHTË FAJTOR

Sepse, me datë 01.04.2023, rreth orës 11:00 min, në territorin e fshatit G., Komuna e V., ne pyllin shtetëror, në vendin e quajtur "Zharrina", i pandehuri S.E. me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm pasuror për vete, me dashje, me sharrë motorrike ka prerë 22 copë trungje të njoma, të llojit bung, me diametër në cung 16-18 cm, në lartësi 17.5 cm, me gjatësi 7 m, me vëllim të përgjithshëm 2.73 m³, të cilat i ka bartur me traktor të markës IMT 533, në këtë mënyrë i pandehuri me veprimet e tij të kundërligjshme të dëmtuarën APK, zyra në V. i ka shkaktuar dëm material në shumë prej 245 €.

-me këtë veprim ka kryer veprën penale vjedhja e pyllit nga neni 349 par.1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në bazë të nenit 4, 7, 17, 38, 43 të KPRK-së dhe nenit 450, 458, 495 par. 1, 2 dhe 3 të KPPRK-së, të pandehurit të lartcekur:

I SHQIPTON

Dënim me gjobë

Ashtu që për veprën penale sipas dispozitivit të këtij aktgjykimi, i caktohet dënim me gjobë në shumën prej 100.00 € (njëqind euro), të cilin dënim i pandehuri obligohet t'a paguajë në afat prej 15 ditësh, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i plotfuqishëm.

Nëse i pandehuri nuk dëshiron, nuk mundet ose nuk mund t'a paguajë gjobën, atëherë gjykata do t'ia zëvendësojë dënimin me gjobë në dënim me burgim, ashtu që 1 (një) ditë burgim do të barazohet me 20€ (njëzet) të dënimit me gjobë.

E dëmtuara Agjencioni Pyjor i Kosovës, zyra në V. për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko civil.

Obligohet i pandehuri që të paguajë paushallin gjyqësor në shumën prej 20€, në afat prej 15 ditëve pasi që ky aktgjykim të marrë formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarimit ligjor.

Arsyetim

Prokuroria Themelore në Gjiilan, Departamenti i Përgjithshëm, me datë 10.08.2023, në Gjykatën Themelore Gjiilan, Dega e gjykatës në V., ka paraqitur aktakuzën me numër PP.II.nr.1100/2023, të datës 31.07.2023, ndaj të pandehurit S.E.nga fshati G., Komuna e V. për shkak të veprës penale vjedhje pylli nga neni 349 par.1 të KPRK-së.

Me të njëjtën datë sikurse aktakuza, është paraqitë edhe kërkesa PP.II.nr.1100/2023, e datës 19.07.2023, për dhënien e urdhërit ndëshkimor me shqiptimin e dënimit me gjobë, me arsyetimin se janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 493 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të KPPRK-së.

Gjykata pas leximit dhe analizimit të aktakuzës përkatëse dhe shkresave të lëndës së bashku me kërkesën për dhënien e urdhërit ndëshkimor, gjeti se në këtë çështje penalo juridike, janë plotësuar kushtet nga neni 493 i KPPRK-së për dhënien e urdhërit ndëshkimor dhe bazuar në nenin 495 par. 1, 2 dhe 3 të KPPRK-së, vendosi që të pranojë kërkesën e lartë cekur ashtu që të pandehurit t'i shqiptojë dënimin me gjobë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ngase të dhënat e paraqitura në aktakuzë si dhe provat e bashkëngjitura në të, ofrojnë bazë të mjaftueshme për një gjë të tillë dhe deri tek një konstatim i tillë gjykata erdhi duke u bazuar edhe në shkresat e lëndës siç janë: fletëparaqitja për dëmtimin e pyllit e Administratës së Ekonomisë dhe Pylltarisë të Komunës së V. me numër 58, e datës 21.06.2023, me vlerësimin dhe llogaritjen e dëmtimit të pyjeve me numër 1/20, nga ditari i rojës, i datës 23.05.2023, si dhe dokumentacioni tjetër përcjellës, gjeti se këto janë prova të besueshme dhe të mjaftueshme mbi bazën e të cilave konstatohet bindshëm se i pandehuri ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë me aktin akuzues.

Andaj, bazuar në të lartë cekurat gjykata konsideron se edhe me shqiptimin e dënimit me gjobë ashtu siç është propozuar në kërkesën për dhënien e urdhërit ndëshkimor mund të arrihen qëllimet e dënimit të parapara në nenin 38 të KPRK-së.

Duke pasur parasysh se në dispozitivin e aktakuzës është cekur vlera e dëmit mirëpo lidhur me llogaritjen e këtij dëmi nuk ka ndonjë ekspertizë të veçantë por e njëjta është bërë në bazë të kalkulimit nga vet e dëmtuara gjykata konsideron se të njëjtat nuk ofrojnë bazë të mjaftueshme për gjykimin e plotë e as të pjesërishtë të kërkesës pasurore juridike andaj edhe bazuar në nenin 462 paragrafi 2 të

KPP-ës, të dëmtuarën Agjencioni Pyjor i Kosovës, dega në V. për realizimin e kërkesës pasurore juridike e udhëzoi në kontest të rregullt juridiko civil.

Vendimin sa i përket shpenzimeve procedurale, gjykata e mori duke u mbështetur në nenin 450 par. 1 të KPP-së.

Nga të lartë cekurat dhe mbështetur në nenin 495 paragrafi 1, 2 dhe 3, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA V.
Departamenti i përgjithshëm
P.nr.335/2023, Datë 26.01.2024

Gjyqtarja,
Blerina Jakupi Ramadani

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet kundërshtimi në afat prej 8 ditëve nga dita e marrjes së të njëjtit, gjyqtares individuale të kësaj gjykate. Kundërshtimi nuk duhet domosdo të arsyetohet. Pas kalimit të afatit për kundërshtim, urdhërin ndëshkimor merr formën e prerë dhe ekzekutohet dënimi i shqiptuar.